



Prizren, 15.01.2020

LETËR MBËSHTETJE

Të nderuar zonja dhe zotërinj !

Kosova dhe Gjermania synojnë bashkëpunimin në lëminë e shëndetësisë dhe veçanërisht përsheptimin e mëtutjeshëm në certifikimin dhe akreditimin e personelit për kujdes shëndetësor në tregun gjerman të punës.

Ministrat e Shëndetësisë të dy vendeve kanë nënshkruar mes dy palësh me 15. Qershor. 2019 në Prishtinë një Memorandum Bashkëpunimi (shih dokumentin).

Si rezultat i parë i këtij bashkëpunimi u themelua në qytetin tonë në Prizren në gusht të vitit 2019 „German Nursing Academy” Sh.P.K. Aksioneri Hamza Fetahi dhe drejtori Karl B. Gerster vijnë nga regjioni i Bingenit, qytetit nga Gjermania i binjakëzuar me Prizrenin.

Ndërmarrja ka për qëllim që personelin për kujdes shëndetësor të aftësuar në Kosovë, fillimisht në Prizren ta përgatisim për nivelin e kërkuar gjuhësor. Për këtë pjesëmarrësit do të përgatiten në grupe prej 8 – 16 pjesmarrës në kurse intenzive për provimet në Goethe - Institut prej mësuesve të kualifikuar të gjermanishtes.

Si pjesë përbërëse e kësaj oferte të “German Nursing Academy” do të jetë edhe përcjellja aktive e pjesëmarrësve në aplikimin për njohjen e profesionit tek autoritetet përgjegjëse gjermane, në aplikimet e nevojshme për lejeqëndrimin dhe lejen e punës në Ambasadën Gjermane si dhe garantimin e një vendi pune në Gjermani.

Jam i lumtur për suksesin e arritur në sjelljen e “German Nursing Academy” në qytetin e Prizrenit, me qëllim që të rinjve tanë të kualifikuar t’ju ofrojmë një perspektivë të mëtejshme profesionale.

Me përshëndetje miqësore

Mytaher Haskuka

Kryetari i Komunës së Prizrenit

